

P.nr. 59/2016

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NOVOBËRDË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me praktikanten Mimoza Mehmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit, D. G., nga fshati, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti për krime të përgjithshme në Gjilan (PTH), PP.II.nr. 1313/2015 e dat. 27.08.2015 dhe kërkesës së PTH në Gjilan për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, më 13.10.2016, hartoi këtë.

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTH në Gjilan, PP.II.nr. 1313/2015 e dat. 27.08.2016, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të akuzuarit,

D. (S.) G., i lindur më 14.12.1946, në, tani me vendbanim në fshatin, Komuna e Prizrenit, din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme, punon në shtetin e Zviceres, i martuar, baba i tre fëmijeve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves,

është fajtor

Sepse më datën 01.08.2015, rreth orës 16.40 minuta, në rrugën magjistrale Gjilan-Prishtine, saktësisht në fshatin Llabjan, me të arritur nëballë pompës së benzinës "Gafi Petrol", i akuzuari derisa drejtonte automjetin e markës " ", me targa të regjistrimit " ", nga pakujdesia ka shkelur Ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit Rrugor nga neni 83.1 pika b, përkatësisht bënë tejkalim të pasigurte të kolonës së automjeteve- në vije të plote, duke mos u siguruar me parë se me këtë veprim mund të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, me qrast me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme të automjetit të markës " ", me targa të regjistrimit " ", të cilin e drejtonte V. L., i cili poashtu levizte në drejtim të Prishtinës, dhe ishte në kthim e sipër majtas në hyrje të pompës së benzinës " Gafi Petrol", dhe nga kjo goditje përpos dëmeve materiale në të dy automjetet lëndime të lehta trupore pësojnë dy vozitësit e automjeteve dhe pasagjeret e veturës " ", B. L. dhe Q. B., të cilat për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Spitalin Regional të Gjilanit-Qendra Emergjente.

Me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjor, si dhe neneve 4, 41, 46, 73, 75, 85 dhe 86 e në lidhje me nenin 365 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurin e

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej 150 € (njëqindë e pesë dhjetë) Euro, të cilën shumë i pandehuri, i lartëcekur do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që ta arkëtoj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta arkëtoj atë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 €, të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që ta arkëtoj paushallin gjyqësor, në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit V L nga Ferizajo Rr.”, p.nr., B L nga Ferizaji, Rr , dhe Q B nga Ferizaji, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

Arsyetim

PTH-Departamenti për Krime të përgjithshme në Gjilan, ka ngritur aktakuzë, PP.II, nr. 1313/15 e dat. 27.08.2015, kundër të akuzuarit L C, nga fshati, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

PTH, pastaj, ka paraqitur kërkesën, PP.II.nr. 1313/15 e dat. 27.08.2016, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, sipas nenit 493 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, pasi shqyrtoi, aktakuzën e PTH në Gjilan me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH për dhënien e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura: aktakuza, kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënimi me gjobë, kallëzimi penal nr.i rastit, 2015- CR-190 të dt.01.08.2015 i stacionit policor në Gjilan, si dhe Raporti i oficerit me të njëjtin numër dhe datë, deklarata e të pandehurit, dëmtuarve si dhe dëshmitarve, bashkangjitur shkresave të lëndës, siq janë raportet mjekesore me nr.14925/15, 14929/15, 14932/15 dhe 14928/15 te datës 01.08.2015, te lëshuar nga Spitali Regjional ne Gjilan, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor me bindje se edhe ky dënimi i shqiptuar do të ndikojë pozitivisht te i akuzuari dhe se me këtë dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, prandaj e miratoi kërkesën e PTH nga Gjilani, dhe të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor dënimin me gjobë në shumën prej 150 € (njëqindë e pesë dhjetë euro),


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPRK-së.

Konform nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së, të dëmtuarit V L nga Ferizaji Rr.”, p.nr., B L nga Ferizaji, Rr, dhe Q B nga Ferizaji për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

Nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEGA NOVOBËRDË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.59/2016



Procesmbajtësja
[Signature]

Gjyqtari
Hasan Saif
[Signature]

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhrit ndëshkimor mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit K. Nëse kundërshtimi i dorëzohet kësaj gjykate.

